

VENDIM
Nr. 24, datë 28.3.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, paragrafi 4, shkronja “dh”; të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 4, të ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013, “Për sistemin e pagesave”, me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave”, miratuar me vendimin nr. 37, datë 25.6.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, pika 1, shkronja “e” ndryshon me përmbajtje si vijon:

“një ose më shumë përfaqësues në nivel ekzekutiv nga ministritë, të cilat mbulojnë funksionet në vijim, në cilësinë e anëtarit:

i) thesarin e shtetit;

ii) të drejtën për të propozuar akte ligjore të hartuara nga Banka e Shqipërisë;

iii) mbrojtjen e konsumatorit;

iv) regjistrin e gjendjes civile;

v) luftën kundër krimit kibernetik;

vi) inovacionin dhe digjitalizimin e shërbi-meve publike (*e-government*);

vii) dërgesat e emigrantëve;

viii) si dhe funksione të tjera të cilat në varësi të objektivave dhe projekteve mund të ndërliken me funksionin e Komitetit.”;

b) Në nenin 4, shkronjat “f”, “g” dhe “h” shfuqizohen;

c) Në nenin 4, pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l” me përmbajtje si më poshtë:

“një përfaqësues në nivel ekzekutiv nga institucionet financiare jobanka, të cilat kryejnë veprimtarinë e transfertave dhe pagesave dhe/ ose të parasë elektronike dhe operatorët e infrastrukturës, të licencuar në bazë të ligjit “Për sistemin e pagesave”, në cilësinë e anëtarit; përfaqësuesit mund të marrin pjesë në mbledhje me përfaqësim ose në formë individuale.”;

d) Në nenin 4, pika 3 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“Në mbledhjen e Komitetit, në varësi të tematikave të përcaktuara në rendin e ditës, mund të marrin pjesë si vëzhgues aktorë të tjerë kryesorë të sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregjeve financiare të tillë si: shoqëritë utilitare, shoqëritë e telekomunikacionit, përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës, ekspertë të huaj të fushës së sistemeve apo shërbimeve të pagesave etj.”;

e) Në nenin 4, pika 4, adresa elektronike e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave” ndryshon nga komiteti@bankofalbania.org në komitetiKSP@bankofalbania.org”;

f) Në nenin 6, pika 1 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“Komiteti mbledhet si rregull të paktën 1 herë në vit, si dhe me kërkesë të anëtarëve me të drejtë vote, të përcaktuar në nenin 4, pika 1, sa herë gjykohet e nevojshme.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko